

Konkurs Për vende të lira pune

Organizata	Handikos Ferizaj (Shoqata e Personave me Aftësi të Kufizuara)
Qëllimi i Angazhimit	Në kuadër të projektit të mbështetur nga Ministria për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare, Handikos Ferizaj shpall thirrje për angazhimin e një Psikolog/e për ofrimin e shërbimeve profesionale në qendër. Kandidatja do të jetë përgjegjëse për vlerësimin e nevojave psiko-sociale të fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara, ofrimin e këshillimit individual dhe grupor, hartimin e planeve mbështetëse, si dhe bashkëpunimin me familjet dhe stafin profesional me qëllim përmirësimin e mirëqenies emocionale, sociale dhe zhvillimore të përfituesve të shërbimeve.
Lokacioni	Ferizaj, Kosovë
Kohëzgjatja	12 muaj
Data e Fillimit	1 Korrik 2026
Koeficienti	5.45

Handikos Ferizaj

Shoqata e Personave me Aftësi të Kufizuara Handikos Ferizaj punon për të arritur njohjen, përfshirjen dhe pjesëmarrjen e plotë të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri, si dhe angazhohet në mënyrë aktive në mbrojtjen, promovimin dhe avokimin për të drejtat e tyre në nivel lokal.

Në kuadër të projektit “Përmirësimi i Mirëqenies së Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara përmes Shërbimeve Multidisiplinare”, i mbështetur nga Ministria për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare, Handikos Ferizaj shpall konkurs për angazhimin e një (1) Psikologu/e, i/e cili/a do të angazhohet në ofrimin e shërbimeve profesionale për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre në kuadër të aktiviteteve dhe shërbimeve të organizatës

Qëllimi i përgjithshëm

Qëllimi i përgjithshëm i projektit është të përmirësojë mirëqenien, zhvillimin dhe cilësinë e jetës së fëmijëve me aftësi të kufizuara përmes ofrimit të shërbimeve multidisiplinare profesionale dhe të qëndrueshme. Projekti synon të adresojë nevojat individuale të fëmijëve në aspektin fizik, psikologjik, social dhe edukativ, duke krijuar mundësi për zhvillimin e potencialit të tyre, rritjen e pavarësisë funksionale dhe përfshirjen aktive në familje dhe komunitet.

Përmes bashkëpunimit të një ekipi multidisiplinar të përbërë nga profesionistë të fushave të ndryshme, projekti do të ofrojë mbështetje të integruar për fëmijët dhe familjet e tyre. Shërbimet do të fokusohen në forcimin e aftësive zhvillimore, përmirësimin e mirëqenies psiko-sociale, fuqizimin e prindërve dhe krijimin e një mjedisi më gjithëpërfshirës, duke kontribuar në

realizimin e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe pjesëmarrjen e tyre të barabartë në shoqëri.

Një (1) Psikolog/e

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Të ofrojë shërbime terapeutike psiko-sociale individuale dhe në grup për fëmijët me aftësi të kufizuara.
- Të hartojë dhe zbatojë plane individuale të punës për përfituesit, duke u bazuar në vlerësimin profesional dhe nevojat zhvillimore të secilit rast.
- Të punojë në mënyrë aktive me prindërit/kujdestarët, duke ofruar këshillim, udhëzime dhe mbështetje për përmirësimin e përfshirjes dhe mirëqenies së fëmijëve në familje.
- Të ndihmojë në zhvillimin e shkathtësive jetësore, me qëllim rritjen e pavarësisë dhe funksionimit më efektiv në jetën e përditshme.
- Orar i plotë pune (40 orë në javë).

Kualifikimet dhe eksperiencia

- Diplomë Universitare, dega Psikologji;
- Licencë për shërbime sociale dhe familjare (e preferueshme)
- Të paktën një (1) vit përvojë pune profesionale (e preferueshme)
- Shkathtësi ndër personale dhe të komunikimit;

Aplikuesit duhet të dorëzojnë

- Biografi-CV
- Kopjen e dokumentit të identifikimit
- Dëshminë për përgatitjen profesionale(kopjen e diplomës)
- Dëshminë për Licencën për shërbime shëndetësore apo shërbime sociale (Kopjen e certifikimit / licencës)
- Dëshminë për praktiken profesionale (dëshminë e përvojës së punës)
- Letër- motivimi
- Letër rekomandim

Procedurat e aplikimit

Aplikacionet duhet të dorëzohen vetëm në formë elektronike në e-mail adresën: prokurimihandikos@gmail.com me subjektin : *Aplikoj për “pozita psikolog/e”*, afati i fundit për dorëzimin e aplikacionit është **19.06.2026 ora 23:59h.**

Vetëm kandidatët e listës së ngushtë do të kontaktohen. Gjatë gjithë procesit nuk ofrohen informata me telefon.